



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 16 Prill 2021

Nr. 247

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj kandidatit për deputet të Republikës së Shqipërisë z. Petrit Malaj, Drejtorisë së gjimnazit “Asim Vokshi”.

Kërkues: Partia Demokratike

Ndaj: z. Petrit Malaj, kandidat për deputet i Partisë Socialiste
Drejtorisë së gjimnazit “Asim Vokshi”

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, dhe 78, pika 6, 91, 92, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREJ:

I. Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë administruar disa denoncime nga subjekti politik Partia Demokratike, për shkelje të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.



Sipas denoncimit të datës 22.3.2021, administruar në KQZ me nr. 2445 prot., denoncimit të datës 26.3.2021, administruar në KQZ me nr. 2713 prot., dhe denoncimit të datës 3.4.2021, administruar në KQZ me nr. 3183 prot., të subjektit politik Partia Demokratike, pretendohet: “Shkelje të neneve 78, pika 6, 92 pika 1 dhe 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, pika 1.1 dhe neni 3 shkronja “b” “ç” dhe “d” të vendimit nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator”.

“Në datën 16.3.2021, kandidati për deputet z. Petrit Malaj ka zhvilluar aktivitete të fushatës elektorale në kundërshtim me bazën ligjore të sipërcituar, referuar videos së lancuar në faqen zyrtare të po këtij kandidati për deputet, në palestrën e gjimnazit “Asim Vokshi”, shihet qartë shkelja brenda orarit zyrtar të punës në institucion publik, kandidati për deputet promovon vaksinimin e mësuesve si arritje për të qeveris ku me fund të videos vendos sloganin e Partisë Socialiste.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk i’a njuh shprehimisht Rregullatorin apo Kas-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Partia Demokratike, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

Neni 78, pika 6, parashikon se “Ndalohet zhvillimi i fushatës zgjedhore në institucionet publike”.

Neni 92, pika 1 dhe 6, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, përcakton se “Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për



pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre” dhe mosraportimi i veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ ose ndërmarrjeve shtetërore, ose zhvillimi i tyre, pavarësisht ndalimit nga KQZ-ja ngarkon me përgjegjësi personin përgjegjës, si dhe titullarin përkatës të institucionit kur ai ka penguar zbatimin e kësaj dispozite.

Neni 3, pika 1.1, i vendimit 9/2020 përcakton se “veprimtari të ndaluara për t’u promovuar” janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:

b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik;

ç) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi;

d) mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore.

Pika 2 e nenit 3, e vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator, përcakton subjektet të cilët gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi.

Duke qenë se denoncimet lidhen edhe me kandidatin për deputet z. Petrit Malaj, Komisioneri konstaton se deputeti nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të fillojë një procedurë administrative të kërkuar nga denoncuesit për shkak të mungesës së kompetencës ndaj subjektit.

Referuar po kësaj dispozite, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve konstaton se Zyra Arsimore Vendore Tropojë dhe Drejtoria e gjimnazit “Asim Vokshi” janë subjekte të ngarkuara për zbatimin e këtij vendimi.

II. Rrethanat e faktit



Data: 16 Prill 2021
Nr. 247

Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj kandidatit për deputet të Republikës së Shqipërisë z.Petrit Malaj, Drejtorisë së gjimnazit “Asim Vokshi”

Komisioni Rregullator në KQZ me datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Ky vendim, në nenin 4 të tij, përcakton detyrimin e institucioneve publike për të kryer raportimin e të gjitha veprimtarive publike në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas përcaktimeve të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator “Veprimtari publike”, janë të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, apo të medias në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.

Referuar denoncimeve të mësipërm Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2669 prot., datë 25.3.2021, ka kërkuar informacion Zyrës Vendore Arsimore Tropojë.

- Me shkresën nr. 105 prot., datë 29.3.2021, protokolluar në KQZ me nr. 2669/1, datë 1.4.2021, Zyra Vendore Arsimore Tropojë ka sqaruar se: “Në datën 16 mars 2021 në mjedisin e hapur të palestrës së shkollës është organizuar puna për ngritjen dhe funksionimin e qendrës së vaksinimeve për mësuesit e ZVA Tropojë, sipas grafikut të NJVKSH, bazuar në udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe planit të veprimit të hartuar në bashkëpunim me Zyrën Arsimore Vendore. Drejtoresha e kësaj zyre zj. Shotë Bashaj ka qenë në këtë ambient pikërisht për të rakorduar punët me zyrtarët shëndetësorë të NJVKSH-së.

Kandidati për deputet, z. Petrit Malaj i ndodhur në rrugën kryesore të qytetit, pranë kësaj qendre ka dëgjuar për fillimin e vaksinimit të mësuesve në Tropojë dhe për një moment është përshëndetur me punonjësit shëndetësorë për impenjimin e tyre. Ka qenë ky komunikimi i të pranishmëve me kandidatin për deputet dhe asgjë tjetër, asgjë e organizuar apo planifikuar nga zyrtarët e Zyrës Vendore Arsimore, konkretisht drejtoresha e zyrës, zj. Shotë Bashaj. Duke respektuar Kodin Zgjedhor dhe konkretisht neni 6 pika 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

E konsiderojmë një rastësi spontane dhe krejt pa ndikimin tonë qëndrimin për një çast në ambientin e vaksinimeve të kandidatit për deputet dhe nuk ka asnjë indicie që tregon për një veprim të planifikuar tonin me karakter politik apo favorizim të veprimeve politike të një subjekti. Pavarësisht edhe faktit që ky veprim ka ndodhur në një moment kur nuk kishte filluar zyrtarisht fushata elektorale dhe pa prezencën e mësuesve aty”.



III. Analiza ligjore

Neni 2, shkronja “b” përkufizon si veprimtari publike veprimtaritë të cilat janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim si dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën 4 mujore para datës së Zgjedhjeve deri ditën e Zgjedhjeve.

Neni 3, pika 2 e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, ka përcaktuar rrethin e subjekteve të cilët ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sipas përcaktimit të cilit përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi janë edhe:

... drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi.

Referuar sa më sipër, ndalimi lidhet vetëm në rastet kur veprimtaria publike është e hapur për publikun apo të medias dhe kanë agjendë informimi apo është veprimtari e ndaluar në kuptim të përkufizimeve të pikës 1.1, të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator dhe kjo veprimtari kryhet nga subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij vendimi.

Neni 3, pika 1.1, i vendimit 9/2020 përcakton se “veprimtari të ndaluara për t’u promovuar” janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:

- b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik;
- ç) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore.

Në referim të informacionit të përcjellë nga Zyra Arsimore Vendore Tropojë, prania e kandidatit për deputet në ambientet e vaksinimeve të palestrës së gjimnazit “Asim Vokshi” ka qenë e rastësishme, çmohet se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se kemi të bëjmë me një veprimtari të ndaluar për sa



kohë që nuk vërtetohet karakteri publik i tij qoftë nëpërmjet aksesit të publikut apo të medias për të marrë pjesë në veprimtari. Publikimi në profilin e Facebook të një veprimtarie administrative nga z. Petrit Malaj nuk dëshmon karakterin publik të aktivitetit.

Postimi dhe veprimtaria janë dy ngjarje të dallueshme qartë nga njëra tjetra dhe të zhvendosura në kohë. Nga ana tjetër, Facebook-u apo media të tjera sociale nuk bëjnë pjesë në kategorinë “media” që kërkon pika 1 e nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Dispozita kërkon “pjesëmarrje” të medias, që t’u konsiderojë veprimtarinë publike.

Rrethanat e faktit nuk provojnë zhvillimin e një veprimtarie publike për t’u promovuar sipas përcaktimeve të pikës 1.1 të nenit 3 të vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.

Neni 6, pika 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator parashikon se: “Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet çdollos pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politikë apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje”.

Për sa më sipër çdo aktivitet që do të zhvillohet nga institucionet publike me kandidatët për deputet, gjatë fushatës zgjedhore konsiderohet aktivitet në mbështetje të një subjekti të caktuar politik.

Neni 78, pika 6, parashikon se “*Ndalohet zhvillimi i fushatës zgjedhore në institucionet publike*”.

Referuar pikës 1, të nenit 77, të Kodit Zgjedhor, “*Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve*”.

Referuar datës së zhvillimit të aktiviteteve nuk jemi kushtet e ndalimit të nenit 78 pika 6, pasi aktivitetet janë zhvilluar para datës së fillimit të fushatës zgjedhore.

Referuar denoncimeve të mësipërme këto veprimtari të Drejtorisë së gjimnazit “Asim Vokshi” Tropojë nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të provojnë se janë veprimtari të ndaluara në kuptim të përkufizime të veprimtarive të ndaluara të përcaktuara në nenin 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n” pika 2, dhe nenet 78, pika 6, 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe



vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimeve për deputetin z. Petrit Malaj, për shkak se nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.
2. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimeve për arsye se nuk konstatohen elemente të shkeljes së dispozitave të nenit 78 pika 6, 92 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.
3. Të njoftojë Zyrën Arsimore Vendore Tropojë, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë që në respektim të standardit të zgjedhjeve dhe neutralitetit të administratës publike, deputetët dhe kandidatët për deputet, deri në datën e zgjedhjeve të mos ftohen dhe të mos lejohen në veprimtaritë të administratës qendrore dhe vendore të tyre.
4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 16 Prill 2021
Nr. 247

Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj kandidatit për deputet të Republikës së Shqipërisë z.Petrit Malaj, Drejtorisë së gjimnazit “Asim Vokshi”